

KONTRATË PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT JO-SHTËPIAK

Kjo kontratë është lidhur ndërmjet Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike -SH. A.- Divizioni për Furnizim (tani e tutje "Furnizuesi") me adresë: _____ dhe të cilën e përfaqëson personi zyrtar

_____ dhe "Konsumatorit" me shënimet si në vijim:

Emri i plotë i Konsumatorit Komercial (personit juridik):	
Emri i plote i perfaqesuesit te autorizuar te konsumatorit komercial (pronari, drejtori menaxhues, etj.):	
Nr. i Letërnjoftimit të Përfaqësuesit të Autorizuar të Konsumatorit:	
Adresa e shërbimit (selia e biznesit):	
Adresa e faturimit: (nëse është e ndryshme nga adresa e shërbimit) (numri i objektit/shtëpisë/banesës, emri i rrugës, qyteti/fshati):	
Lloji i Biznesit:	
Numri i Regjistrimit të Biznesit:	
Numri i telefonit:	
E-mail adresa:	
Grupi tarifor:	
Shifra e Konsumatorit në KESCO-Furnizuesi: (nëse është konsumator ekzistues)	
Niveli i tensionit: Fuqia maksimale (kW):	
Të dhënat e llogarisë bankare Emri i bankës: Numri i llogarisë:	

PJESA B - KUSHTET E FURNIZIMIT

1. KRITERET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME

- 1.1 Kjo kontratë i përcakton kriteret dhe kushtet për furnizim dhe shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesit dhe Konsumatorit.
- 1.2 Në bazë të ligjeve të Kosovës, Furnizuesi i nënshtrohet rregullave të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) përkitazi me kushtet e furnizimit me energji elektrike, caktimin e tarifave, procedurave për zgjidhjen e kontesteve si dhe çështjeve tjera të ndërlidhura me konsumatorin (por jo kufizuar në):
 - (a) Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
 - (b) Rregullin mbi Shkryçjen dhe Rikryçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë
 - (c) Rregullin mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë
 - (d) Rregullin mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve) si dhe në tarifatat në fuqi të miratuara nga ZRRE-ja.
- 1.3 Rregullat dhe procedurat e miratuara nga ZRRE-ja, mbi bazën e të cilave është hartuar kjo kontratë, mund të gjinden në secilën zyrë për përkujdesje ndaj konsumatorëve të Furnizuesit, apo në faqen elektronike zyrtare të Furnizuesit ose të ZRRE-së.

2. TE DREJTAT DHE OBLIGIMET E KONSUMATORIT

2.1 Konsumatori do:

- (a) të furnizohet ashtu siç është përcaktuar në këtë kontratë dhe në kontratën për kyçje;
- (b) të shfrytëzojë energjinë elektrike në përputhje me këtë kontratë;
- (c) të përmbahet nga çdo shfrytëzim i paautorizuar, keqpërdorur i energjisë elektrike, dëmtim të pikës matëse apo pajisjeve për matje;
- (d) të paguaj energjinë e konsumuar të matur si dhe energjinë e konsumuar të pamatur për çfarëdo arsye, por të shpenzuar, sipas tarifave në fuqi;
- (e) të informojë menjëherë Furnizuesin në rast të ndonjë ndërrimi të të dhënave me rastin e lidhjes së kontratës si: emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e llogarisë bankare, përfshirë edhe dyshimet në saktësinë e matjes dhe dëmtimet eventuale të stabilimenteve matëse etj.;
- (f) të respektojë të gjitha rregullat dhe procedurat e miratuara nga ZRRE-ja, posaçërisht dispozitat e Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike dhe Rregullit për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë.
- (g) të ofrojë një lokacion për pikën matëse që do të ishte e përshtatshme për Furnizuesin për të matur energjinë elektrike.

3. TE DREJTAT DHE OBLIGIMET E FURNIZUESIT

3.1 Furnizuesi do:

- (a) të furnizoj konsumatorin me energji elektrike në sasinë dhe cilësinë e pajtuar me këtë kontratë dhe sipas kodeve dhe standardeve në fuqi, nëse furnizimi me cilësi më të ulët dhe sasi të pamjaftueshme nuk është autorizuar përkohësisht nga ZRRE-ja, si pasojë e kushteve të përkohshme të furnizimit dhe rjetit të furnizimit. Vetëm në këtë kontekst, kjo kontratë nuk garanton furnizim të pandërprerë me energji elektrike për konsumatorin;
- (b) të sigurojë faturimin e saktë të energjisë elektrike të konsumuar;
- (c) të pranojë pagesën për energjinë elektrike të faturuar dhe shërbimeve tjera brenda kornizës së përcaktuar me rregullat dhe procedurat e ZRRE-së;
- (d) t'i ofrojë konsumatorit lajmërim paraprak prej 24 orësh nëse ka ndërprerje të planifikuar të furnizimit me energji elektrike, në pajtim me udhëzimet e ZRRE-së;
- (e) të informoj konsumatorin për çfarëdo ndërprerje të paplanifikuar/emergjente, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e paraparë të kësaj ndërprerjeje.
- (f) të rikthejë furnizimin me energji elektrike për konsumatorin pas ndërprerjes sa më shpejt që është e mundur e në përputhshmëri me kodet e miratuara nga ZRRE-ja;
- (g) të mbledhë dhe monitorojë të dhënat gjegjëse lidhur me konsumin e energjisë elektrike nga ana e konsumatorit.
- (h) të bëjë leximin e njehsorëve për energjinë elektrike të konsumuar nga konsumatorët sipas rregullave të lartpërmendur dhe procedurave përcjellëse të miratuara nga ZRRE-ja;
- (i) të bëjë kompensimin e dëmit të dokumentuar, i shkaktuar konsumatorit për shkak të mosdërgimit të energjisë elektrike dhe për dërgim të energjisë elektrike me cilësi të dobët në kundërshtim të pajtimit me këtë kontratë;
- (j) të bëjë kompensimin e dëmit të dokumentuar, i shkaktuar konsumatorit të rregullt në pagesë për shkak të shkyçjes së energjisë elektrike në kundërshtim me procedurat për shkyçje të përcaktuara në Rregullin për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

4. FATURIMI I ENERGJISE ELEKTRIKE TE KONSUMUAR

4.1 Energjia elektrike e konsumuar llogaritet sipas tarifave të rregulluara dhe aprovuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

4.2 Furnizuesi do të llogaris faturën e konsumatorit duke u bazuar në leximin mujor të njehsorit dhe tarifën e miratuar nga ZRRE-ja ose në bazë të tarifës paushalle, aty ku nuk ka mundësi tjetër. Konsumatori do të njoftohet për çfarëdo ndryshimi të çmimit apo tarifës dhe mënyrës së leximit në pajtim me rregullat dhe procedurat e ZRRE -së. Informata mbi tarifën mund të gjinden në secilën zyre për përkujdesje ndaj konsumatorëve të Furnizuesit në faqen elektronike zyrtare të Furnizuesit ose ZRRE -së.

4.3 Në rast të gabimeve që rrjedhin si pasojë e leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë Furnizuesi do të bëjë të gjithë rregullimet e nevojshme në faturën vijuese, atëherë kur kjo pasaktësi mund të identifikohet me kërkesën e konsumatorit.

5. NDËRPRERJET E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës për ndërprerjet e shkaktuara nga çfarëdo rrethanë apo veprim që është jashtë kontrollit të arsyeshëm, nga shkaqet natyrore: vetëtimja, zjarri, stuhia, vërshimi, tërmeti, thatësia, akumulimi i dëborës apo akullit, mungesës së ujit si pasojë e shkaqeve të motit apo të ambientit ose ndonjë defekt tjetër, dështim apo ndërprerje e sistemit të transmisionit.

6. NDERPRERJA E KONTRATES

6.1 Konsumatori mund ta ndërpresë kontratën kurdoqoftë, pa ndonjë shkak, duke iu nënshtruar:

- (a) Njoftimit paraprak me shkrim prej 3 (tri) ditësh në Departamentin për Përkujdesje ndaj Konsumatorëve dhe
- (b) Përmbushjes së të gjitha obligimeve kontraktuese deri në datën e ndërprerjes.

6.2 Furnizuesi gjithashtu mund ta ndërpresë kontratën në pajtim me Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike si dhe Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, ose çfarëdo rregulli apo procedure të miratuar nga ZRRE-ja.

7. ANKESAT DHE SHQETËSIMET E KONSUMATORIT

7.1 Konsumatori ka të drejtë të kërkon sqarime, të bëjë komente apo ankesë, përkitazi me zbatimin e kushteve të kësaj kontrate. Për këtë ai mund të kontaktojë Departamentin për Përkrahje ndaj Konsumatorëve të Furnizuesit përmes telefonit të kujdestarisë për konsumatorë të Furnizuesit ose edhe përmes postës së rregullt.

7.2 Të gjitha ankesat kërkesat apo shqetësimet e konsumatorit që janë të ndërlidhura apo që burojnë nga kjo kontratë do të zgjidhen në pajtim me Rregullin mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë si dhe procedurave të brendshme të Furnizuesit të aprovuar nga ZRRE-ja.

8. RUAJTJA E TË DHËNAVE

8.1 Furnizuesi i ruan të dhënat personale të ofruara nga Konsumatori në këtë Kontratë me qëllim të zbatimit të kritereve të veta, për të administruar llogarinë e Konsumatorit si dhe për të ushtruar të drejtat e veta sipas ligjit. Për më tepër, Furnizuesi mund t'i ruaj të dhënat e Konsumatorit edhe pas ndërprerjes së Kontratës dhe mund t'i dërgoj këto të dhëna institucioneve të autorizuara në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që mund të lejojnë një veprim të tillë.

9. DATA E HYRJES NE FUQI

9.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën kur Furnizuesi ose Konsumatori, cilido që është i fundit, e nënshkruan këtë dokument.

Data e fillimit të furnizimit me energji elektrike: _____

Nënshkrimi i Përfaqësuesit të Autorizuar të Konsumatorit:	
Emri dhe Mbiemri i Përfaqësuesit të Autorizuar të Konsumatorit. (ju lutem shkruani me shkronja të qarta të shtypit):	
Emri i personit juridik (afarist): (ju lutem shkruani me shkronja të qarta të shtypit)	
Data:	

Për dhe në emër të KESCO:	
Emri dhe numri i punës së punëtorit të KESCO:	
Data:	